



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0522

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Agon Ramadani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Valdrini sh.p.k, kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KOMUNA GLLOGOC në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gllanasellë , Godanc dhe Asfaltimi i rrugës në fshatin Gradicë , Likoshanë - Projekt dy vjeçar me numër të prokurimit 611-23-5116-5-2-1, me 31/10/2023, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjeserisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Valdrini SH.P.K.&Benita Company” SH.P.K.. , e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 26.07.2023 (me numër protokolli 522/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Asfaltimi i rrugëve ne fshatin Gllanaselle, Godanc dhe Asfaltimi i rrugës ne fshatin Gradicë,Likoshan-Projekt dy vjeçar. “ me nr. të prokurimit:"611-23-5116-5-2-1"&"611-23-056-521, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gllogoc.

2. Të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

3.Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 22.05.2023, Komuna Gllogoc , në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Asfaltimi i rrugëve ne fshatin Gllanaselle,

Godanc dhe Asfaltimi i rrugës ne fshatin Gradicë,Likoshan-Projekt dy vjeqar.” me nr. të prokurimit: :”611-23-5116-5-2-1”&”611-23-056-521. Nderkaq me datën 18.07.2023 eshte publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

OE“Valdrini SH.P.K.&Benita Company” SH.P.K.. me datën 16.07.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. AK- Komuna Gllogoc me vendim ka refuzuar kërkesën per rishqyrtim te OE. “Valdrini SH.P.K.&Benita Company” SH.P.K.. lidhur me aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i rrugëve ne fshatin Gllanaselle, Godanc dhe Asfaltimi i rrugës ne fshatin Gradicë,Likoshan-Projekt dy vjeqar” me numër te prokurimit: :”611-23-5116-5-2-1”&”611-23-056-521. inicuar nga – Komuna Gllogoc.

AK ne vendim ka kërkuar te mbetet ne fuqi njoftimi mbi vendimin per dhënie i AK – Komuna Gllogoc lidhur me aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i rrugëve ne fshatin Gllanaselle, Godanc dhe Asfaltimi i rrugës ne fshatin Gradicë,Likoshan-Projekt dy vjeqar” me numër te prokurimit:”611-23-5116-5-2-1”&”611-23-056-521.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE“Valdrini SH.P.K.&Benita Company” SH.P.K.. ankuesme datën 26.07.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 522/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës:320,573.00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 08.08.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE “Valdrini SH.P.K.&Benita Company” SH.P.K..

Të aprovet pjesërisht si e bazuar, si dhe të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Pretendimi nr.1

OE ankues, i pakënaqur me vendimin e AK-se, ka parashtruar ankese ne OSHP, për aktivitetin e prokurimit: Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gllanasellë , Godanc dhe Asfaltimi i rrugës në fshatin Gradicë , Likoshanë - Projekt dy vjeçar, i cili pretendon se AK-ja, ka rekomanduar për kontrate një operatore ekonomik te papërgjegjshëm.

OE ankues pretendon se AK-ja, nuk e ka trajtuar siç duhet kërkesën për rishqyrtim pra ne kundërshtim me nenin 108/A paragrafin 8 nen paragrafin 8.4 te LPP-se sepse nuk i ka trajtuar pretendimet tona te paraqitura ne kërkesën për rishqyrtim ne përputhje me kriteret e përzgjedhjes te parapara ne NJK dhe DT, interpretim te gabuar te dispozitave te paragrafit 2. nën paragrafi 2.1 dhe 2.2 te nenit 4 te Ligjit nr. 04/L-037,, për arsimin e larte ne Republikën e Kosovës, po ashtu dispozitat e nenit 4 paragrafi 1 dhe 2 te Udhëzimit Administrativ MASHT 11/2015.

OE ankues pretendon se autoriteti kontraktues me rastin e rekomandimit për kontrate te Grupi i Operatoreve ekonomik N.T Fer-Petroll: N.N.SH. World Medium, nuk ka vepruar ne harmoni me dispozitat e LPP-se,


OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontrate, nuk e plotëson kërkesën për inxhinier te gjeodezisë sepse AK-ja, ka kërkuar qe inxhinieri duhet te ketë 5 vite përvojë pune pas diplomimit dhe sipas OE ankues Inxhinieri i gjeodezisë Faton Bajselmani, ka diplomuar (Master) me: 07.10.2019, ndërsa diploma si bachelor i gjeodezisë sipas OE ankues nuk duhet te merret parasysh sepse nuk konsiderohet inxhinieri i diplomuar.

Eksperti shqyrtues sqaron se, AK ne dosjen e tenderit ka kërkuar :

3.Një	3.Kontrata
Inxhinier iose	
Diplomuar i marrveshje	
Gjeodezisë,e	
nje	noterizuar
gjeodet me	dy
përvoje	palve me
min 5 vite	(titull te
nga data e tenderit,	
diplomimit	diploma e
) ne lemine	noeterizuar
e	cv-ja
gjeodezise	deshmia e
	pervojes.

Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar ne tërësi te gjitha shkresat e lendes, duke përfshirë pretendimin e OE ankues, rrjedhën e kësaj procedure te prokurimit sqaron se OE i rekomanduar për kontrate, lidhur me te inxhinierin e gjeodezisë, ka ofruar si pjese te stafit (Faton Bajselmani – Master i shkencave teknike te ndërtimtarisë-Gjeodezi). Eksperti shqyrtues sqaron se, Faton Bajselmani poashtu është i diplomuar ne studimet themelore universitare ne Fakultetin e

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne shkresat e lendes vlerëson se OE i rekomanduar për kontrate, e ka plotësuar kërkesën e dosjes se tenderit te cituar me larte, për faktin se Agjensioni Kadastral ka lëshuar licence profesionale për inxhinierin Faton Bajselmani, dhe nuk mund te thuhet se i njëjti nuk ka përvojë pune pas diplomimit për faktin se i njëjti është i pajisur me licence për kryerjen e matjeve kadastrale. Poashtu i njëjti inxhinier e dëshmon përvojën e tij te punës edhe përmes CV-se dhe referencave te dorëzuara. Pra, sipas dëshmive te dorëzuara ku inxhinieri ne fjale ka diplomuar ne vitin 2010 dhe bazuar ne referencat dhe CV-in e dorëzuar, ky inxhinier e plotëson kërkesën e dosjes se tenderit.



Prandaj, ekspertit shqyrtues, vlerëson se AK-ja, nuk e ka bere vlerësimin e ofertave konform nenit 59 te LPP-se, sepse mbi bazën e neni 59 dhe 72 është dashur te beje verifikimet e nevojshme dhe pastaj te rekomandoje për kontrate operator ekonomik te përgjegjshëm, për faktin se sipas nenit 59.4 tor et i o tra tu s o t ë o d o ë n ë e e r i t ë p g g h m e t m n e t n e i n ë a ë ë h t ë ë p u t h ë r i e t ë g t h a ë e a t e a r a h t r u a r a n ë n o t n e o t r a t s d e n ë d e n e t e d a n k u e s n u k m u n d t e b e h e t s e p s e i r e k o m a n d u a r i p ë r k o n t r a t e i k a d o r ë z u a r

disa dëshmi të cilat duhet të vlerësohen me ne detaje.

Konstatimet e panelit shqyrtues

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në raportin e ekspertizës janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Paneli shqyrtues do të ndalet për shpjegim të mëtutjeshëm sa i përket kërkesë "*Një Inxhinier i Diplomuar i Gjeodezisë*, Një Inxhinier i Diplomuar i Gjeodezisë, një gjeodet me përvojë min 5 vite (nga data e diplomimit) ne lemine e gjeodezisë" për shkak se eksperti shqyrtues nuk e ka shpjeguar më në detaje dhe për të cilën ankuesi është i pakënaqur me mendimin e ekspertit. Për panelin shqyrtues pretendimi kishte me qenë i bazuar dhe konform udhëzimeve administrative të MASHT sikur kërkesa të ishte dizajnuar më ndryshe dhe sikur përvoja të ishte ndërlidhur me inxhinierin e diplomuar të gjeodezisë. Por kërkesa është e dizajnuar/formuluar në tjetër mënyrë dhe është e ndarë në dy pjesë në pjesën e parë është kërkuar një inxhinier i diplomuar i gjeodezisë dhe në pjesën e dytë është kërkuar, një gjeodet me përvojë min 5 vite (nga data e diplomimit) ne lemine e gjeodezisë, sipas kërkesës së Dosjes së Tenderit kjo përvojë është e ndërlidhur me një gjeodet i cili duhet të ketë përvojë 5 vite në lëmin e gjeodezisë dhe jo me inxhinierin e diplomuar të gjeodezisë. Kështu që, edhe OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar inxhinierin e diplomuar të gjeodezisë i cili është me master dhe sipas CV së ofruar dhe dokumenteve tjera është i diplomuar si bachelor i gjeodezisë që nga viti 2010 dhe që nga atëherë përvoja e tij ndërlidhet me lëmin e gjeodezisë, nëse AK eventualisht ka ndonjë dyshim rreth përvojës së tij mund të vë në zbatim nenin 52.7 të LPP përndryshe, për panelin shqyrtues sa i përket kësaj pike OE i rekomanduar për kontratë e ka plotësuar kërkesën e Dosjes së Tenderit.

Ndërsa sa i përket pretendimit tjetër sa i përket pajisjeve, obligohet AK të veproj konform rekomandimit të dhënë në raportin e ekspertizës. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues se aktiviteti i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 dhe 72 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA GLLOGOC**
- **OE - Valdrini sh.p.k**
- Arkivës së OSHP-së: